

VENDIM
Nr.153, datë 11.2.2009

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT TË DISA
MJEDISEVE NË NDËRTESEN (GODINËN) E INIMA-S

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 23.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim Qendrës Kombëtare të Licencimit të disa mjediseve, në katin e dytë, në ndërtesën e ish-INIMA-s, në administrim të Këshillit të Ministrave, sipas vendndodhjes së përcaktuar në planimetrinë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr.614, datë 12.9.2007 “Për dhënie në përdorim të Agjencisë së Prokurimeve Publike të disa mjediseve të ndërtesës (godinës) së ish-INIMA-s”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Kryeministria dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

